



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ**

PROCESVERBAL

**KONSULTIM PUBLIK PËR BUXHETIN AFATMESËM PËR VITET 2026-2028 PËR
BASHKINË KAMËZ**

I mbajtur më 03.07.2025, në orën 19:30, në dëgjesën me banorët e Bashkisë Kamëz, në lidhje me planifikimin e buxhetin afatmesëm për vitet 2026-2028.

Takimi u zhvillua në Stadiumin Kamëz.

Të pranishëm në takim ishin:

- Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli;
- Deputetja e zonës, znj. Lindita Nikolli;
- Administratorët e Njësive dhe Lagjeve Administrative të Bashkisë Kamëz;
- Anëtarë të Këshilli Bashkiak;
- Ndërlidhësit me komunitetin;
- Qytetarë të Kamzës.

Takimi u hap me fjalën përshëndetëse të administratores së Lagjes Administrative Nr. 2, znj. Blerta Matraku, e cila pasi falënderoi qytetarët për pjesëmarrjen, i njohu ata me qëllimin e këtij takimi konsultues.

Më pas fjala i kaloi deputetes së zonës, znj. Lindita Nikolla, e cila falënderoi Kryetarin e Bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli, për punët e realizuara në territorin e bashkisë. Gjatë fjalës së saj, ajo u shpreh: “Nuk ka asgjë më të mirë dhe më të përgjegjshme sesa kur sheh se vota përkthehet në punë konkrete, në shërbime reale, në rezultate të prekshme dhe në vepra të mira për komunitetin. E tillë ka qenë edhe vota që ju i keni dhënë Kryetarit Rakip Suli.

Kjo e sotmja është një ditë e veçantë, një ditë kur demokracia funksionon në mënyrën më të drejtpërdrejtë. Kryetari i zgjedhur prej jush, përmes votës së lirë, vjen sot përpara qytetarëve të tij për të dhënë llogari për punët e kryera, por edhe për të dëgjuar mendimet, propozimet dhe shqetësimet tuaja për të ardhmen.

Sepse kështu ndërtohet një komunitet më i mirë duke menduar për fëmijët tanë, për të ardhmen tonë të përbashkët, për një jetë me më shumë dinjitet dhe mundësi. Kështu di të shërbejë Rakip Suli, duke bashkuar vullnete, njerëz, dhe ndihmuar më të dobët, pa bërë dallime apo paragjykime. Unë besoj fort se edhe sot, Rakipi do të dëshmojë sërish modelin e një qeverisjeje lokale të suksesshme, një kryetar bashkie që është në radhë të parë kryeshërbëtori i qytetarëve, një njeri që di të dëgjojë dhe të marrë vendime përmes bashkëbisedimit me ju, duke ju bërë pjesë të vendimmarrjes.”

Në përfundim të fjalës së saj, deputetja Nikolla falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për prezencën dhe theksoi modelin e suksesshëm të qeverisjes së z. Rakip Suli, si një shembull se si punohet dhe si merren vendimet në shërbim të qytetarëve.

Më pas, fjalën e mori Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli, i cili shprehu mirënjohjen e tij për deputeten e zonës, znj. Lindita Nikolla, dhe të gjithë qytetarët pjesëmarrës. Ai u ndal fillimisht te rëndësia e konsultimeve publike: “Nuk është e pazakontë që në Kamëz të mblidhemi dhe të diskutojmë së bashku për punët e qytetit dhe sfidat që na përbashkojnë. Megjithatë, emocionet janë të njëjta, ndjenja e bukur e realizimit të premtimeve që kemi marrë përsipër.

Falë vendimeve të përbashkëta dhe diskutimeve të vazhdueshme, Kamza sot është kthyer në një model të zhvillimit ekonomik, urban dhe social. Këto janë tre shtyllat kryesore që përbëjnë themelin e mirëqenies për çdo familje e qytetar në Kamëz.

Ne jemi të hapur për diskutime, jo për vendime të njëanshme. Bashkia, në bashkëpunim me Këshillin Bashkiak, nuk ka alternativë më të mirë sesa ky kuvend, ku diskutojmë dhe marrim vendime të përbashkëta.

Qëllimi i këtij takimi është informimi dhe marrja e vendimeve për çështje që prekin drejtpërdrejt çdo individ dhe familje në territorin e Bashkisë Kamëz.”

Më tej, Kryetari Suli vuri theksin te punët e kryera dhe investimet e realizuara gjatë viteve të fundit në Bashkinë Kamëz, duke u shprehur: “Gjatë këtyre viteve kemi bërë ndryshime rrënjësore, veçanërisht në arsim, ku kemi investuar në 40 objekte arsimore, duke garantuar kushte më të mira për nxënësit dhe mësuesit. Po ashtu, kemi investuar rreth 140 km në sistemin e kanalizimeve dhe mbi 212 km në rrjetin e ujësjellësit, duke zgjidhur përfundimisht çështje të vjetra të infrastrukturës bazë.

Në infrastrukturën rrugore kemi ndërtuar dhe rehabilituar rreth 235 km rrugë, duke lehtësuar lëvizjen e banorëve dhe lidhjen me pjesë të tjera të qytetit. Përmes nenit 6 dhe nenit 7 kemi lehtësuar proceset për ndërtimet e banesave, ndërsa kemi ofruar sistemin TIP për ndërtimet, duke e bërë më të qartë dhe të sigurt procesin për qytetarët.

Nuk kemi lënë pas dore as të rinjtë, të cilët janë e ardhmja e qytetit tonë, ndaj kemi dhënë 640 bursa ekselence për t’i motivuar dhe mbështetur në rrugën e tyre drejt suksesit.

Sa i përket pastrimit të qytetit, që nga data 28 mars 2024, ai menaxhohet tërësisht nga Bashkia Kamëz. Kemi blerë mjete pastrimi dhe kemi ngritur një ekip të mirëorganizuar, i cili ka sjellë një transformim të ndjeshëm, sot Kamza është më e pastër se kurrë më parë.

Një vëmendje të veçantë i kemi kushtuar edhe forcave zjarrfikëse, të cilat shpesh përballen me sfida ekstreme në raste fatkeqësish natyrore. Kemi ndërtuar një stacion të ri zjarrfikës, kemi vënë në gatishmëri tre automjete zjarrfikëse, kemi pajisur ekipin me autoshkallë dhe uniforma të reja, të përshtatura për çdo situatë emergjente.

Ne jemi e vetmja bashki që, për çdo shtëpi të djegur, e dëmshpërblejmë pronarin brenda muajit. Janë shlyer të gjitha dëmshpërblimet e prapambetura për banesat e djegura që nga viti 2013, një angazhim që e kemi marrë seriozisht dhe që e kemi mbajtur me përgjegjësi.”

Punët e bëra në këto 6-vite

❖ *Investimet 2019-2025, Bashkia Kamëz*

- Janë ndërtuar dhe investuar 40 objekte arsimore, nga të cilat :
 - 18 shkolla ;
 - Me laboratore;

- Sistem ngrohje dhe ftohje;
- Ambjente sportive;
- 16 kopshte;
- 6 çerdhe;
 - Ambjente të sigurta dhe funksionale për zhvillimin e fëmijeve;
 - Me ushqim dhe fjetje;
 - Sisteme ngrohje, ftohje;
 - Staf profesional dhe te trajnuar;
 - Kënde Lojrash;
- Infrastrukturë rrugore 235 km, nga të cilat:
 - Në Lagjen Nr.1, përfunduar 51.4 km rrugë;
 - Në Lagjen Nr.2, përfunduar 48,5 km rrugë;
 - Në Lagjen Bathore, përfunduar 55,3 km rrugë;
 - Në Njësinë Paskuqan, përfunduar 80,4 km rrugë;
- Kanalizime 140 km
- Ujësjellës 212 km
- Rritja e abonentëve të kontratave të ujësjellësit nga 16, 700 abonent në 31,500
- Rindërtimi nga tërmeti : 426 banesa individuale
- Pallate Valias : 19/270 apartamente
- Rehabilitimi i pallateve: 54 pallate / 831 familje përfituese
- Në Parku e Liqenit të Paskuqanit kanë përfunduar.
 - Pedonalja 5.1 km
 - 2 parkime në të dyja anët
 - 53,000 pemë të mbjella, kontribut i qytetarëve dhe bizneseve
- Ndërtimi i Shëtitores së Bathores.
- Krijimi i stacionit zjarrfikës në Valias.
- Blerja e makinave të pastrimit të qytetit.

❖ ***Të Rinjtë***

- 640 studentë kanë përfituar bursa ekselence, për rezultate të larta në mesime

- Nga klasa 6-9, marrin 270\$ në vit dhe
- Nga klasa 10-12, marrin 450\$ në vit
- 162 ekiye sportive , me 1550 të rinj të aktivizuar në sporte të ndryshme.
- Panairi i Librit “Kamza Lexon”.
- Klubi i Librit.
- Konkurse artistike për të rinjtë.
- Këshilli Rinor.
- Praktika Pune.
- Karta e studentit.

❖ *Taksa dhe Tarifa vendore*

- Nga 1 janari sistemi online i taksave
- Për çdo biznes të ri që hapet në Bashkinë Kamëz vitin e parë përjashtohet nga taksa.

Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024	Deri më 31 maj 2025
375 Subjekte	404 Subjekte	480 Subjekte	353 Subjekte

- Ulja e tarifave dhe taksave me 60 % për biznesin e vogel

Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
3014 Subjekte	3102 Subjekte	3382 Subjekte

- Taksat familjare: Lehtësira dhe përjashtime të taksave dhe tarifave familjare për kategoritë në nevojë:
 - Invalid
 - Kryefamiljare Gra
 - Pensionistët e vetmuar

- Familje që jetojnë në emigracion
- Familje që trajtohen me ndihmë ekonomike

Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
4165 Familjarë	5829 Familjarë	5967 Familjarë

❖ **Planifikimi dhe Zhvillimi Territorial 2025**

- Neni 6 dhe 6/1 lehtësimet e punimeve
 - Sistemi Kapot
 - Izolim Çatie
 - Ndërtim Çatie
 - Të gjitha punimet e brendëshme
 - Sistemimi i oborrit
- Projekti TIP që përfitojnë familjarët falas:
 - TIP Banesë 1+1
 - TIP Banesë 2+1
 - TIP Banesë 3+1

❖ **Politikat Ekonomike Sociale 2025**

- 2.3 milion buxheti për programet sociale.
- Taksa 0 për familjet në nevojë .
- 258 familje trajtohen me bonus qeraje nga strehimi social .
- 180 familje te prekura nga unaza e madhe trajtohen me bonus qiraje
- 5000 lekë/muaj fëmijët me status jetim.
- 5000lekë/muaj për të moshuarit të vetmuar
- 530 fëmijë në kopshte dhe çerdhe pa pagesë
- 70 fëmijë trajtohen tek Qendra Multifunkionale
- 45 persona shërbim në familje logopedi dhe fizioterapi

- 68 familje- kredi të butë
 - 2 antarë në familje -> 3,440,250 lekë
 - 3-4 anëtarë në familje -> 5,066,550 lekë
 - 5 anëtarë dhe më shumë -> 6,255,000 lekë
- Punësimi i personave me aftësi ndryshe.

❖ **INVESTIME TË PLANIFIKUARA**

➤ **Objektet Arsimore**

- Gjimnazi “Sulejman Elezi” është ndërtuar nga e para dhe përfundon në fund të vitit;
- Kopshti Qendër Kamëz;
- Rikonstruksion i shkollës “Dom Nikoll Kaçorri”;
- Rikonstruksion i fushave sportive të shkollës “100 Vjetori”.

➤ **Shëtitorja Frutikulturë**

- Projekti i shëtitores Frutikulturë, me ndikim të drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së banorëve, po i afrohet përfundimit :
 - Nga e cila do të përfitojnë 20,000 banorë:
 - Pedonalia Frutikulturë ka një gjatësi prej 1.3 km
 - Me kënde lojërash
 - Ambiente për të moshuarit

➤ **Parku i Liqenit të Paskuqanit investime në proces:**

- Amfiteatri
- Moli
- Terrene sportive
- Kënde lojrash

- Kanalizimet

➤ **Infrastrukturë Rrugore**

- Gjatë këtyre viteve janë planifikuar 77 km rrugë të reja në total.
 - Në Lagjen nr. 1, janë planifikuar të investohet në 75 rrugë, me gjatësi 18.5 km
 - Në Lagjen nr. 2, janë planifikuar të investohet në 70 rrugë, me gjatësi 11.2 km
 - Në Lagjen Bathore, janë planifikuar të investohet në 83 rrugë, me gjatësi 17.7 km
 - Në Njësin Paskuqan, janë planifikuar të investohet në 89 rrugë, me gjatësi 21.1 km

➤ **Ndërtimi i Stadiumit Valias**

- Ndërtimi i Stadiumit në Valias është një investim i rëndësishëm në infrastrukturen sportive të zonës. Ky projekt synon të krijojë një hapësirë moderne për aktivitetet sportive dhe ndeshje futbolli, duke nxitur angazhimin e të rinjve në sport.

➤ **Qendra e Bashkisë Kamëz**

- Ndërtimi i Qendrës së Bashkisë Kamëz është një projekt ambicioz, që synon të transformojë zemrën e qytetit, në një hapësirë më të bukur, funksionale dhe në shërbim të qytetarëve.
 - Qendra e Bashkisë do të ndërtohet në hapësirën e fushës së Kamzës
 - Sheshi i Qendes së qytetit do të ketë një sipërfaqe prej 13,000 m²
 - Është planifikuar një parkim nëntokësor me sipërfaqe 3,000m²
 - Me hapësira rekreative për qytetarët
- Pjesë këtij projekti do të jetë dhe Godina e re Bashkisë Kamëz, e cila do të shërbeje si simbol i zhvillimit të qytetit.
 - Godina e Bashkisë do të ketë 3 kate, me sipërfaqe 3,000m²

- Së fundi u diskutua për transportin publik, sfidat dhe përmirësimin e tij.

Secilit pjesëmarrës në takim ju dha mundësia dhe koha për të bërë pyetje dhe për të dhënë sugjerimet e tyre mbi palanifikimin e buxhetit të viteve 2026-2028.

Takimi u mbyll me një falënderim të përzemërt nga kryetari Suli për pjesëmarrësit, duke i siguruar ata se çdo sugjerim i tyre do të merret parasysh për tu implementuar në buxhetin 2026-2028.

Bashkangjitur foto:











